

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"B.T EDIL GROUP" Shpk

Kavaje 08.01.2024

Ortakët themelues:

1. Flavio Dylaver Daja lindur dhe banues ne Luzi Vogel, Kavaje me ID J20225063B.
Bazuar në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar), ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" (i ndryshuar), sot më datë 08.01.2024 harton këtë Akt Themelimi të shoqërisë tregtare si më poshtë vijon;

NENI 1

Emri

1.1 Shoqëria tregtare mban emrin "B.T EDIL GROUP" shpk

1.2 Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Ortakëve të Shoqërisë.

NENI 2

Forma

2.1 Shoqëria tregtare "B.T EDIL GROUP" shpk, ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 3

Zyra Qendrore

3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar "B.T EDIL GROUP" shpk do të ketë zyrën e saj qendrore në adresën: Rrogozhine zone kadastrale 3235 pasuria nr. 497/37.

NENI 4

Objekti i Veprimtarisë

4.1 Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj ne fushen: prodhime inertesh, rere, çakull, gure, mermer etj. Prodhim e tregtim materiale ndertimi dhe materialeve te ndryshem industriale, prodhim e tregtim me shumice e pakice i pllakave te te gjitha



llojeve dhe dimensioneve. Import-Eksport makineri, pajisje e materiale ndertimi, germime dheu, transport mallrash te ndryshme etj.

NENI 5

Kohëzgjatja

5.1 Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë "B.T EDIL GROUP" do të jetë me afat të pacaktuar.

NENI 6

Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit

6.1 Shoqëria tregtare "B.T EDIL GROUP" shpk mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

NENI 7

Përgjegjësia e Ortakëve

7.1 Ortakët nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë "B.T EDIL GROUP" Shpk dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tyre.

NENI 8

Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "B.T EDIL GROUP" Shpk është 2.500.000 (dy milion e peseqind mijë) lekë.

Ortakët e shoqërisë janë:

1. Z. Flavio Daja është zotërues i 1 (një) kuote e cila përbën 100% të kapitalit të shoqërisë.

NENI 9

Organet e Shoqërisë

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.



NENI 10

Administratori

Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Ortakë e Shoqërisë. Afati i emërimit është 5(Pese)vjet. Kompetencat e administratorit përcaktohen në statutin e shoqërisë.

Administrator i Shoqërisë është **Z. Flavio Daja** lindur dhe banues ne Luzi Vogel, Kavaje, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i pasaportës me numër J20225063B .

Ky Akt Themelimi përpilohet në 4 (katër) origjinale në gjuhën shqipe, të gjitha me të njëjtën vlerë ligjore.

ORTAKËT

E SHOQERISË ME PERGJEGJESI TË KUFIZUAR

"B.T EDIL GROUP" Shpk

Flavio Daja

